



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.9.Regj.Them

Datë: 25 maj 2021

Datë regjistrimi: 24.05.2021

VENDIM

“PËR BASHKIMIN E ÇËSHTJEVE”

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim më datë 24.05.2021, ora 13.38, çështja që i përket:

Paditës: Kreshnik Merxhani.

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Tiranë.

Objekti:

1. Kundërshtimin e vendimit të KQZ/KAS, nr.86, datë: 19.05.2021.
2. Gjykimin e çështjes në themel duke vendosur pranimin e plotë të padisë.
3. Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve.
4. Përsëritjen e zgjedhjeve në qarkun e Gjirokastrës.

Baza ligjore: Neni 145 e në vijim i ligjit nr. 10019 date 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i përditësuar.

Më datë 25.05.2021 u hodh shorti publik për përcaktimin e përbërjes së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor që do të shqyrtojë çështjen dhe sipas tij trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

- 1) Alma Kolgjoka (relatore),
- 2) Asim Vokshi (anëtar),
- 3) Gentian Medja (anëtar),
- 4) Manjola Xhaxho (anëtare),
- 5) Sokol Ibi (anëtar).

Rezulton se më datë 24.05.2021, ora 14.36 është paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Apelit çështja me nr.10.akti, datë regjistrimi 24.05.2021 që i përket:

Paditës: Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI).

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Tiranë.

Objekti: Ndryshimi i vendimit nr.86, datë: 19.05.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanskioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Baza ligjore: Neni 145 e vijues i Kodit Zgjedhor të RSH.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, vlerëson se çështja nr.10.akti, datë regjistrimi 24.05.2021 ka lidhje për nga objekti me çështjen e regjistruar më parë me nr.9.akti, datë regjistrimi 24.05.2021, për të cilën është hedhur shorti për përcaktimin e trupës gjyqësore. Në zbatim të neneve 57, 158/a(ë) të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 154 e 155 të Kodit Zgjedhor, çështja e paraqitur më pas me nr.10.akti, datë regjistrim 24.05.2021, do të bashkohet me çështjen e regjistruar më parë me nr.9.akti, datë regjistrimi 24.05.2021 dhe do të gjykohen në një gjykim të vetëm.

Në këto kushte, në zbatim të neneve 57, 158/a(ë) të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 154 e 155 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

VENDOSA:

1. Bashkimin e çështjes së paraqitur më pas me nr.10.akti, datë regjistrimi 24.05.2021, me paditës LSI, me çështjen zgjedhore të regjistruar më parë e cila mban nr.9.akti, datë regjistrimi 24.05.2021, me paditës Kreshnik Merxhani.
2. Ngarkohet sekretaria gjyqësore sëbashku me punonjësit gjyqësorë të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, t'i njoftojnë këtë vendim bashkimi palëve, si dhe subjekteve të tjera të interesuara që kanë qenë pjesëmarrëse në procedurën e ankimit administrativ pranë KAS, për vendimmarrjen objekt gjykimi.
3. Tiranë më 25 maj 2021.

KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES GJYQTARE RELATORE

Alma KOLGJOKA

